



01/Nr. 676/2024  
Data : 12.08.2024

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2024 e Komitetit për Politikë e financa, mbajtur me datë 18.07.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2024.
3. Raporti i auditorit për pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 nga zyra kombëtare e auditimit.
4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2023.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.
6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveq këtyre pikave të rendit të punës kemi edhe një material shtesë, Kërkesë për plotësim ndryshimin e kërkesës me numër 04/5243/2024 për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare. për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2024.
3. Raporti i auditorit për pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 nga zyra kombëtare e auditimit.
4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2023.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.
6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Kërkesë për plotësim ndryshimin e kërkesës me numër 04/5243/2024 për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinanciare.
9. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Natyra Kalisi** thekson:- në mbledhje e fundit të Komitetit për Politikë e Financa nuk kam qenë pjesëmarrëse dhe emri është te prezenca në mbledhje atëherë kërkoj të përmirësohet.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në material i keni në mënyrë të detajuara shpenzimet financiare për periudhën në fjalë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sherif Berisha** thekson:- sa persona i kanë marr mjetet financiare që kanë të bëjnë me gjykatat, pra kërkoj sqarim se a bëhet fjalë për shujta, kualifikim apo për çështje tjera. Kërkoj sqarim kodin buxhetorë përfaqësimeve brenda vendit .

**Lindita Ballazhi** thekson:- kodi ekonomikë për vendimet gjyqësore përfshihen pagesat që kanë të bëjnë me shujtat dhe obligimet nga kontrata kolektive. Sa i përket personave të cilët kanë përfituar prej vendimeve gjyqësore përgjigjen mund ta merrni nga zyra ligjore sepse nuk është në përgjegjësi të drejtorisë sonë. Sa i përket kodit përfaqësimeve brenda vendit ka të bëjë me drekat zyrtare .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI FINACIARE PËR PERIUdhËN JANAR –QERSHORË 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



### **3. Raporti i auditorit për pasqyrave financiare vjetore për vitin 2023 nga zyra kombëtare e auditimit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- raporti i auditimit ka rezultuar me pesë të gjetura dhe çka është me rëndësi se është me çështje të pamodifikuar. Prej pesë rekomandimeve dy rekomandime janë të reja ndërsa tri prej tyre janë të përsëritura. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Hyriete Isufi** thekson:- pse janë bërë vonesat në pagesa.

**Sherif Berisha** thekson:- janë zhvilluar procedurat pa urdhër blerje dhe në fillim vit keni potencuar se keni me zbatuar planin dhe del që nuk e keni zbatuar. Shuma e buxhetit është mbi tre milionë euro dhe nuk keni auditorë të brendshëm dhe kur do të fillon procedura për auditorë të brendshëm. Janë rritur borxhet për 70, 000 € dhe është mirë të merren masa për këtë çështje.

**Lindita Ballazhi** thekson:- vonesat në disa raste janë të paevitueshme dhe këto vonesa kanë rezultuar për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm. Sa i përket auditorit e kemi planin e veprimit se si do ta zgjidhim, mirëpo nuk varet vetëm prej neve i komunë për shkak se për të planifikuar një auditorë të brendshëm duhet prej Ministrisë përkatës duhet të na aprovohet një pozitë shtesë. Komuna mundohet të bëjë inkasimin e borxheve përmes letër kujtesave të ndryshme.

**Hyriete Isufi** thekson:- a keni bërë kërkesë në Ministrinë përkatëse për me u bërë një vend i tillë për çështjen e auditorit.

**Lindita Ballazhi** thekson:- kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për çështjen e auditorit por nuk na është aprovuar prej Ministrisë një pozitë e tillë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTU RAPORTI I AUDITORIT PËR PASQYRAVE FINACIARE VJETORE PËR VITIN 2023 NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2023.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- është bërë plani për zbatimin e rekomandimeve dhe në mënyrë të detajuar i keni të shënuara përgjegjësitë për zbatimin e rekomandimeve.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTU PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË AUDITIMIT 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



## 5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevdi Dernjani** thekson:- gjatë këtij gjashtë mujori janë mbajtur gjithsejtë katër mbledhje dhe prej tyre tri të rregullta dhe një mbledhje e jashtëzakonshme. Në material i keni të shënuar pjesëmarrësit të cilët marrin pjesë në mbledhje. Janë diskutuar çështjen si siguria në komunën tonë, siguria në komunikacion. Është diskutuar çështja e dukurive negative edhe nëpër fshatra , droga, bixhozi teknologjik dhe është kërkuar nga policia që t'i njofton njësitet përgjegjëse të policisë për këtë çështje dhe të bashkëpunon me qytetarë për këtë çështje. Është diskutuar çështja e zebrave dhe çështja e dëmeve të shkaktuara nga breshëri.

**Sherif Berisha** thekson:- në letër janë radhitur fenomenale por kërkoj nga nënkryetari i komunës që të na sqaron se te cila pikë jeni ndaluar më shumë dhe keni ndërmarr diçka.

**Sevdi Dernjani** thekson:- kryetari i komunës ka përgjegjësi që të jep rekomandimet e duhur karshi personave kompetentë. Ju e dini që për sigurinë në komunën tonë është policia dhe kryetari jep rekomandime dhe sugjerime për komunën tonë dhe nuk mundet me bërë diçka tjetër, ndërsa trajtimi i qenve endacak, çështja e lëndëve narkotike, çështja e lojërave onllajnë, kryetari në këto takime i diskuton me personat të cilët janë përgjegjës. Në këto takime marrin pjesë edhe zyrtarët nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha këto shqetësime përcillen në nivel qendrorë .

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTU INFORMATA PËR AKTIVITET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kompania figuron me 320 ekonomi familjare të cilët i kanë borxh kompanisë , nuk e di se cili komision ka vendosur që sekretaria dhe arkëtarja me pasur pagën e njëjtë. Kush e kryen punë e zyrtarit financiarë i cili ka dhënë dorëheqje.

**Sevdi Dernjani** thekson:- janë pyetje që duhet përgjigje me dhënë edhe komisioni i aksionarëve dhe bordi i drejtorëve.

**Sherif Berisha** thekson:- çdo herë kam kërkuar që të marr pjesë në takimet e bordit të drejtorëve të kompanisë por deri më sot nuk kam pasur ftesë asnjë herë.

**Hyriete Isufi** thekson:- sa i përket borxheve potencohet se ju kemi dërguar letër kujtesa që me kryer pagesën prej pesëmbëdhjetë ditëve dhe një pjesë ju kanë përgjigjur por nuk e dimë sa ka qenë dhe nuk është asgjë që me ditur përqindjen.

**Kryesuesi** thekson:- është tu pasur efekt puna e njoftimeve. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U VOTU RAPORTI FINANCIARË PËR PERIU DHËN JANAR –QERSHOR 2024 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND



## 7. Informatë për sektorin e emergjencave.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Arsim Dernjani** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Sherif Berisha** thekson:- a keni pasur fond emergjentë si komunë dhe nuk e di se pse nuk i keni lënë qytetarët që me ju drejtuar drejtë për drejtë Qeverisë. Kush ka qenë në komision dhe si po ndryshohet komisioni dhe nuk janë marr me të gjithë personat.

**Arsim Dernjani** thekson:- edhe kryetari i komunës ka deklaruar nëpër media se nuk kemi fond emergjentë. Komisioni është duke i shqyrtuar të gjitha kërkesat në mënyrë transparente dhe pastaj do të përcillen në Ministri përkatëse.

**Sevdi Dernjani** thekson:- komuna nuk e ka ndaluar asnjë qytetarë për me parashtruar kërkesë në nivel qendrorë për me u bërë kompensimi i dëmeve që i ka shkaktuar breshëri por komuna ju ka dal për krahë qytetarëve. Kryetari i komunës ka thirr mbledhje të jashtëzakonshme të KKSB-së dhe janë identifikuar të gjitha problemet. Pas mbledhjes së KKSB-së është marr vendim dhe është rikonstruar vendimi i komisionit dhe komisioni ka qenë në gatishmëri për pranimin e të gjitha aplikacioneve që qytetarët kanë pretenduar që ju kanë shkaktuar dëme breshëri. Nuk është e vërtetë ajo që thoni që ne i kemi ndaluar qytetarët për mos me aplikuar në nivel qendrorë por qytetarët kanë gjetur një adresë pak më të lehtë në komunë dhe komuna do ti dorëzon aplikacionet në nivel qendrorë .

**Sherif Berisha** thekson:- takim keni pasur me nivelin qendrorë dhe përgjigjen e keni marr që i keni rritur çmimet pra keni kalkuluar diçka që nuk është me ato norma që i keni pas dhe që ka qenë i njoftuar edhe niveli qendrorë .

**Sevdi Dernjani** thekson:- është mirë që kur ta parashtroni pyetjen mos me dezinformuar dhe në asnjë moment nuk janë fryer çmimet e ankesave të qytetarëve por komisioni prej nivelit qendrorë ka ardhur me rekomandimet të cilat ka potencuar se është mirë me i pasqyruar dëmet reale dhe qytetarëve ju kemi sugjeruar që dëmet të cilët janë shkaktuar prej breshrit është mirë që me i paraqitur në mënyrë reale përmes ankesave dhe ashtu siç i kanë parashtruar ankesat në ato kalkulime kemi kalkuluar dhe nuk i kemi fryer çmimet për me i dërguar në nivel qendrorë dhe ende komisioni nuk e ka bërë vlerësimin e dëmeve për shkak se janë tu punuar për verifikimin e dëmeve.

**Sherif Berisha** thekson:-vlerësimi kur është bërë është bërë prej anës së juaj dhe me atë vlerësim janë dërguar në nivel qendrorë .

**Kryesuesi** thekson:- është e vërtetë që është bërë dam nga breshëri por mendoj që procesi ka mundur me shkuar pak më ndryshe duke filluar prej njoftimit që është bërë për shkak se dëshira është e madhe për me mbështetur qytetarin por mundësitë janë të vogla. Njoftimi i parë kur është dhënë për qytetarët është dashur me u shënuar në bashkëpunim me Ministrinë në mënyrë që përgjegjësinë me ndarë bashkarishtë me nivelin qendrorë për shkak se ne e dimë që nuk kemi mjete financiare që me u a kompensuar dëmin qytetarëve .



**Sevdi Dernjani** thekson:- edhe më herët potencova për mbledhjen e KKSB-së dhe për çështje të komisionit por ditëve në vazhdim duke e analizuar situatën dhe kemi marr rekomandimet prej nivelit qendrorë duke filluar prej njoftimit dhe kushtet se si do të bëhet vlerësimi pra kanë qenë rekomandime prej nivelit qendrorë dhe komuna i ka zbatuar. Ende nuk është bërë verifikimi kompletë i dëmeve dhe nuk kemi dal me një shumë të saktë se sa është dëmi i shkaktuar ende jemi në proces dhe në momentin që do të përfundon procesi raporti ka me ardhur në kuvend dhe do të përcillte për nivel qendrorë. Është mirë që nëse e kemi si informacion me plasuar si të kompletuar por jo të përgjysmuar dhe në mungesë të informacionit me dezinformuar edhe qytetarin. Është bërë pranimi komplet i aplikacioneve dhe komisioni ka dalur në teren me bërë verifikimin dhe është në proces e sipër.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- që nga data njëzet e një maj e përsërisim të njëjtën fjalë që potencoj nënkryetari se ende nuk na është përcjell për kuvend sepse as qeverisja lokale as niveli qendrorë nuk e dinë por në momentin që do të raportohet në kuvend do të shihen. Nënkryetari i komunës dhe drejtori për shërbime publike kanë qenë në teren dhe është duke kryer punën e vetë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU INFOMATA PËR EKTORIN E EMËRGJENCAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Kërkesë për plotësim ndryshimin e kërkesës me numër 04/5243/2024 për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore pasuri jofinaciare.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në material janë të detajuara se në cilat projekte do të rialokohen mjetet.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU KËRKESA PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E KËRKESËS ME NUMËR 04/5243/2024 PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE JOFINACIARE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7.Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Arbenita Bajramaliu** thekson:- me datë 30.07.2024 do të mbahet festivali internacional që pjesëmarrës janë shtetet nga vendet e ndryshme.

Mbledhja përfundoj në ora 12:48.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

